

VENDIM
Nr.423, datë 2.7.2004

**PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE DHE TË
PENSIONEVE FAMILJARE TË FAMILJEVE TË PILOTËVE, QË KANË HUMBUR JETËN
NË PËRMBUSHJE TË DETYRËS, GJATË FLUTURIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 18 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2004, përfshirë dhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

2. Pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2004, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004 llogariten në shumën 50 100 000 (pesëdhjetë milionë e njëqind mijë) lekë dhe të përballohen nga buxheti i vitit 2004, parashikuar për sigurimin suplementar të ushtarakëve.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano